



22/10/2024  
02/1085

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSUNO  
KOMUNA E SHITES-OPSTINA SHITES  
Nr. Prot. & Prg. 02/278  
Nr. Fjal. & Strana 2  
Data/Dena: 22.10.2024  
SHITES/SHITES

# MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

mes

SHOQATA E MIQËSISË KOSOVË-AUSTRI


Dhe

KOMUNA E SHITES

Për

SHËNIMIN E PËRVITSHËM TË DITËS SË  
SHTETËSISË SË SHTETIT TË AUSTRISË

Tetor, 2024



## Preambula

Ky memorandum i mirëkuptimit ka për qëllim sigurimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve nënshkruese. Me këtë rast, Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri shpreh interesimin që të bashkëpunojnë me komunën e Shtimes me rastin e shënimit të ditës së shtetësisë të shtetit të Austrisë, në shenjë dhe simbolik të rëndësisë së bashkëpunimit mes dy shteteve tona në lëmi të ndryshme, si dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy shteteve mike.

## Neni 1

### Palët

Palë të këtij memorandumit janë Komuna e Shtimes dhe Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri.

## Neni 2

### Qëllimi

Me nënshkrimin e këtij memorandumit palët dakordohen që të bashkëpunojnë me qëllim që të zbatohet objektivi i përcaktuar i këtij memorandumit, përkatësisht shënjimi përvitshëm i Ditës së Shtetësisë së Austrisë në Komunën e Shtimes më datën 26 tetor.

## Neni 3

### Zotimet e palëve

Në kuadër të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Komuna e Shtimes merr përsipër zotimin që me datën e lartcekur (26 tetor) të secilit vit të ngritë në shtizë para objektit të saj (objektit të Komunës) flamurin e shtetit të Austrisë, krahas flamurit shtetëror të Kosovës, në shenjë të respektit dhe miqësisë mes dy shteteve tona.

Shoqata e Miqësisë Kosovë-Austri merr përsipër që me rastin e nënshkrimit të Memorandumi të Mirëkuptimit të bëjë dorëzimin ceremonial dhe simbolik të flamurit të Austrisë tek Kryetari i Komunës Shtimes.

Me rastin e nënshkrimit të këtij MM, komuna e Shtimes nuk ka asnjë kosto apo obligim financiar.

Arsim VRANOVC

Avokat,  
President i Shoqatës Kosovë-Austri

Qemajl ALIU,

Kryetar i Komunës së Shtimes

